ÇFARË NDODH PAS DIPLOMIMIT NGA SHKOLLA? REZULTATET NGA GJURMIMI I TË DIPLOMUARVE 2016-2025

Shkolla Tregtare, Vlorë

© 2026 Swisscontact

Rreth projektit "Aftësi për Punë" S4J

"Aftësi për Punë" S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact. S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Lista e tabelave

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit (2016-2025) 10
Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2025) 16
Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2016-2025) 17
Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2016-2025) 18
Tabela 5: Perceptimet për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2016-2025) 26
Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2016-2025) 27
Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2016-2025) 28
Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2016-2025) 29
Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2025) 32
Tabela 10: Arsyet kryesore të papunësisë (2016-2025) 34
Tabela 11: Arsyet kryesore të mos kërkimit për punë (2020-2025) 35
Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkollë “shumë/jashtëzakonisht shumë” (2016-2025) 36
Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2016-2025) 37
Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2016-2025) 39

Lista e figurave

Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2025) 10
Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2025) 11
Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2025) 11
Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2025) 12
Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2016-2025) 13
Figura 6: Punësimi përkundrejt vetë-punësimit (2016-2025) 14
Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2025) 14
Figura 8: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2025) 15
Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2016-2025) 16
Figura 10: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2025 19
Figura 11: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) (2016-2025) 20
Figura 12: Niveli i pagave sipas drejtimit (2025) 21
Figura 13: Niveli i pagave sipas gjinisë (2025) 22
Figura 14: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt punësimit me kohë të pjesshme (2016-2025) 23
Figura 15: Madhësia e kompanisë (2016-2025) 24
Figura 16: Lloji i kontratës (2016-2025) 25
Figura 17: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2016-2025) 25
Figura 18: Periudha kohore në kërkim të një pune (2025) 27
Figura 19: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2025) 30
Figura 20: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2025) 31
Figura 21: Lloji i institucionit (2020-2025) 31

Figura 22: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2025) 32
Figura 23: Papunësia ndër vite (2016-2025) 33
Figura 24: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2025) 34
Figura 25: Niveli i të diplomuarve të papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2016-2025) 35
Figura 26: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2016-2025) 37
Figura 27: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi dhe e së njëjtës shkollë sipas gjinisë 2025 38

Tabela e përmbajtjes

Lista e tabelave 3
Lista e figurave 3
Gjetjet kryesore 6
Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve? 8
Të diplomuarit 2016-2025 10
Analiza e rezultateve 12
Statusi i punësimit 12
Lidhja e punës me fushën e arsimit 16
Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës 17
Niveli i pagave 18
Kushtet e punës 22
Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqësia në vendin e punës 26
Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë 26
Mënyrat e gjetjes së punës së parë 28
Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme 30
Të diplomuarit pa punë 33
Propozimet për përmirësim në shkollë 36
Planet për të ardhmen 38

Gjetjet kryesore

Ky raport paraqet rezultatet kryesore nga gjurmimi i dhjetë brezave të të diplomuarve të Shkollës Tregtare, duke filluar me brezin e nxënësve të diplomuar në vitin 2016.

- Në vitin 2025, 85.2% e të diplomuarve të gjurmuar ishin të punësuar një vit pas diplomimit. Mes tyre, 63% ishin të punësuar, 7,4% të vetëpunësuar ndërsa 14.8% punonin dhe studionin në të njëjtën kohë. Punësimi ka shënuar një rritje të dukshme me 13 pikë përqindje krahasuar mesataren e punësimit ndër vite 2016 - 2024 (72%).
- Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit për vitin 2025 është 11%. Mesatarisht, për vitet 2016-2025, 17% e të diplomuarve janë të papunë një vit pas diplomimit. 67% ose në numra absolut 4 nga 6 të diplomuarit e papunë të vitit 2025 ishin në kërkim të një pune. Gjithashtu, 33% ose 2 nga 6 nuk ishin në kërkim të një pune.
- Në vitin 2025, 91% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm janë të punësuar. Ndërkohë, drejtimi Ekonomi-Biznes ka të punësuar 74% të të diplomuarve. Nga të diplomuarit të drejtimit Ekonomi- Biznes 16% janë të papunë ndërsa nga të diplomuarit në Hoteleri- Turizëm 9% janë të papunë. Nga të diplomuarit në Hoteleri- Turizëm asnjë nuk ndjek studime të mëtejshme, ndërsa nga të diplomuarit në Ekonomi- Biznes 11%.
- Të disagreguara sipas gjinisë të dhënat mbi statusin e punësimit një vit pas diplomimit tregojnë se përkatësisht 86% e të diplomuarve meshkuj janë të punësuar, 12% janë të papunë dhe 2% janë student ose kursant. Ndërkohë, 83% e të diplomuarve të gjinisë
- femërore janë të punësuara, 8% janë të papuna dhe 8% janë studente ose kursante.
- 57% e të diplomuarve në vitin 2025 u shprehën se puna që bëjnë lidhet me fushën e tyre të arsimit. 54% e të gjurmuarve pohojnë se i përdorin njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë studimit në vendin e punës “shumë/jashtëzakonisht shumë”, duke shënuar një rritje me 3 pikë përqindje në krahasim me vitin e mëparshëm (51%).
- Për vitin 2025, shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 17% deri në 50,000 lekë, 21% në fashën 50,001-60,000 lekë, 31% në fashën 60,001-80,000 lekë dhe 5% paguhen në fashën 80,001- 95,000 lekë, 7% paguhen në fashën 95,001- 120,000 lekë dhe 19% e të diplomuarve paguhen mbi 120,001 lekë.
- Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve 29% e të diplomuarve në degën Hoteleri-Turizëm paguhen më shumë se 120,001 lekë në muaj, ndërkohë asnjë nga të diplomuarve në degën Ekonomi-Biznes nuk paguhet më shumë se 120,001 lekë në muaj. Ndërkohë, 7% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe po 7% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes marrin një pagë 95,001 – 120,000 lekë. Një pagë 80,001-95,000 lekë e marrin 4% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 7% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes. Sikurse pasqyrohet edhe në figurë, 14% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 40% e të diplomuarve ne Hoteleri-Turizëm merre një pagë 60,001- 80,000 lekë. Nga ana tjetër, 14% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 36% e të diplomuarve në Ekonomi- Biznes marrin një pagë 50,001 – 65,000 lekë. Ndërsa pagë nën pagën minimale 50,000 lekë marrin vetëm 36% e të diplomuarve në Ekonomi- Biznes dhe 7% e të diplomuarve në Hoteleri -Turizëm.


- 86% e të diplomuarve në vitin 2025 kanë arritur të gjejnë punë para diplomimit.
- 45% e të diplomuarve të vitit 2025, e kanë gjetur punën përmes praktikës profesionale në biznes duke shënuar përqindjen më të lartë ndër vite. Gjithashtu 17% nga të diplomuarit kanë gjetur punën përmes njoftimeve për punë në faqe interneti, media sociale duke shënuar rritje me 1 pikë përqindje nga mesatarja e 2026-2024 (16%). Ndërkohë 21% e të diplomuarve kanë gjetur punë përmes njohjeve, lidhjeve familjare dhe miqve. duke shënuar një rënie prej 10 pikësh përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (31%). Për më tepër 2% e të diplomuarve në vitin 2025 e kanë gjetur punën duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësit, me një rënie prej 11 pikë përqindje nga mesatarja 2016-2024 (13%).
- 57% e të diplomuarve në vitin 2025, u shprehën se ndjehen “të sigurt” ose “shumë të sigurt” në punën aktuale (shiko tabelën 5). Ndërkohë, të diplomuarit që janë shprehur “shumë të pasigurt” janë vetëm 5%.
- Ndërkohë, 67% e të diplomuarve në vitin 2025 shprehen se ndjehen “të kënaqur ose shumë të kënaqur” dhe asnjë nuk u shpreh “shumë të pakënaqur. Sikurse e tregon edhe tabela vërehet një korrelacion pozitiv mes sigurisë dhe kënaqësisë në vendin e punës.
- Mbi 50% e të gjurmuarve vlerësojnë se çdo aspekt i shkollës ka nevojë për përmirësim “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Theksi këtë vit është tek praktika në shkollë (62%), ndjekur nga praktika në biznes dhe tekstet dhe materialet me 57% secila.
- Pothuajse gjysma e të diplomuarve në vitin 2025 (46%) kanë pohuar se kanë dëshirë të kenë filluar biznesin e tyre brenda dy viteve të ardhshme. Aspiratat për sipërmarrje edhe këtë vit kanë shënuar një rritje me 10 pikë përqindje në raport me mesataren e viteve 2016-2024, 36%. Ndërkohë, 22% e të diplomuarve kanë dëshirë të ndjekin studime të mëtejshme, gjithsesi me një ulje prej 5 pikësh përqindje në raport me mesataren e viteve 2016-2024, 27%. Për më tepër 24% duan të kenë gjetur një punë që lidhet me fushën e tyre të studimit, me një rritje me 1 pikë përqindje sa mesatarja e viteve 2016-2024, 23% dhe 19% duan të jenë të punësuar. Këta të fundit kanë pësuar një rënie me 5 pikë përqindje në raport me mesataren e viteve 2016-2024, 14%.

Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e një institucioni arsimor realizohet përmes 'studimeve gjurmuese' që ndjekin ose 'gjurmojnë' **të diplomuarit** pasi ata diplomohen. Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të arsimit profesional në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.

Të dhënat dhe rezultatet e gjurmimit përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi **relevancën e ofertës** për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura. Tematikat e gjurmimit janë të shumëfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve.

Avantazhet e një sistemi gjurmimi në nivel ofruesi



Në këtë kuadër, Shkolla Tregtare Vlorë, me mbështetjen e projektit 'Aftësi për Punë' (S4J) ka ngritur një **sistem gjurmimi** në nivel ofruesi për të diplomuarit e saj. Ky sistem gjurmimi përmbush dy qëllime të rëndësishme:

a. Monitorimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e shkollës.
b. Vlerësimin e lidhjes (përputhshmërisë horizontale) midis arsimit dhe punës.

Zbatimi i procesit të gjurmimit në praktikë zhvillohet në **tre faza kryesore** siç është e ilustruar në diagramën më poshtë.



Në fazën e para-gjurmimit, që kryhet në majin e çdo viti shkollor, realizohet para-gjurmimi i maturantëve që pritet të diplomohen në qershor. Para-gjurmimi kryhet me anë të një pyetësori të strukturuar online. Anketa mbledh të dhënat e kontaktit të maturantëve, karakteristikat e tyre socio-demografike, si dhe planet dhe pritshmëritë e tyre të karrierës për të mundësuar kështu gjurmimin e tyre një vit më pas.

Në fazën e gjurmimit, që kryhet në qershorin e çdo viti shkollor realizohet gjurmimi i të diplomuarve nga shkolla një vit më parë. Të diplomuarit raportojnë mbi përvojën e kalimit në tregun e punës dhe bëjnë vlerësimin në retrospektivë të shkollës së tyre përmes një pyetësori të standardizuar online duke përdorur platformën Kobo Toolbox.

Në fazën përmbyllëse të procesit analizohen rezultatet e gjurmimit dhe prezantohen rezultatet. Pjesa më e rëndësishme e procesit është leximi i këtyre gjetjeve dhe reflektimi i brendshëm i institucionit mbi të dhënat dhe ndërmarrja e hapave konkrete si rrjedhojë.

Procesi i gjurmimit koordinohet nga **koordinatori i gjurmimit** me mbështetjen e Njësisë së Zhvillimit dhe mësuesve kujdestarë, nën kujdesin e projektit 'Aftësi për punë'.

Ky raport përmbledhës pasqyron rezultatet kryesore nga gjurmimi i **dhjetë brezave me të diplomuar** të Shkollës Tregtare, Vlorë.

Të diplomuarit 2016-2025


Në vitin shkollor 2024-2025, në Shkollën Tregtare u diplomuan 54 nxënës (shiko tabelën 1), 12 nxënës më shumë sesa gjatë vitit 2023-2024.

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit (2016-2025)

Brezi	Të diplomuar	Të anketuar	%
2015-2016	21	8	38%
2016-2017	19	19	100%
2017-2018	48	45	94%
2018-2019	46	43	93%
2019-2020	63	63	100%
2020-2021	63	62	98%
2021-2022	61	61	100%
2022-2023	58	57	98%
2023-2024	42	39	93%
2024-2025	**54**	**54**	**100%**

Nga të diplomuarit e vitit 2024-2025 u gjurmuan 54 nxënës pra 100% e të diplomuarve. Pjesa më e madhe e të diplomuarve të gjurmuar i përkasin gjinisë mashkullore 78% (N=42) dhe vetëm 22% (N=12) gjinisë femërore (shiko figurën 1).


Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=54

Ndërsa të shpërndarë sipas drejtimeve (shiko figurën 2), përqindjen më të lartë të të gjurmuarve e kanë të diplomuarit e drejtimit Hoteleri-Turizëm me 65% dhe më të voglin ata të drejtimit Ekonomi-Biznes me 35%.


Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=54

Të pyetur lidhur me vendbanimin, 89%) e të diplomuarve janë përgjigjur se jetojnë në Shqipëri dhe 11% jetojnë jashtë vendit.

Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2025)




Analiza e rezultateve

Statusi i punësimit

Sipas rezultateve të brezit të fundit të të gjurmuarve (2024-2025), nga një total prej 54 të anketuarish 63% ishin të punësuar një vit pas diplomimit (shiko figurë 4), 7% ishin të vetëpunësuar, 15% ishin të punësuar por edhe studionin në të njëjtën kohë, 4%, ishin student/kursant. Ndërkohë, të papunë ishin 11% e të anketuarve.


Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=54

Referuar figurës 5, 85% e të diplomuarve në vitin 2025 janë të punësuar/vetëpunësuar. Mesatarisht, 2016-2025, 75% e të diplomuarve janë të punësuar një vit pas diplomimit. Ndërkohë, përqindja e atyre që janë të papunë ka ardhur në rënie nga viti në vit, në vitin 2025 kjo përqindje është 11%. Mesatarisht, 2016-2025, 17% e të diplomuarve janë të papunë një vit pas diplomimit. Ndërkohë, përqindja e atyre që vijojnë studimet e mëtejshme këtë vit është 4%.


Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=8); **2017** (N=19); **2018**: (N=45); **2019**: (N=43); **2020**: (N=63); **2021**: (N=62); **2022**: (N=61); **2023** (N=57), **2024** (N=39), **2025** (N=54)

Të anketuarit që janë shprehur se janë në marrëdhënie pune janë pyetur më tej nëse janë të punësuar apo të vetëpunësuar. Sikurse vihet re nga figura 6, shumica e të diplomuarve ndër vite janë shprehur se janë të punësuar dhe një numër i vogël prej tyre janë të vetë-punësuar. Në vitin e fundit të fundit vërehet një rënie e numrit të të diplomuarve të vetëpunësuar. E shprehur në përqindje 63% e të diplomuarve në vitin 2025 janë të punësuar (51% mesatarja 2016-2024) dhe 7% janë të vetëpunësuar (14% mesatarja 2016-2024).


Figura 6: Punësimi përkundrejt vetë-punësimit (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=8); **2017** (N=19); **2018**: (N=45); **2019**: (N=43); **2020**: (N=63); **2021**: (N=62); **2022**: (N=61); **2023** (N=57), **2024** (N=39), **2024** (N=42).

Në figurën 7, jepet statusi i punësimit sipas dy drejtimeve të ofruara nga shkolla. Sikurse vihet re, 91% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm janë të punësuar. Ndërkohë, drejtimi Ekonomi-Biznes ka të punësuar 74% të të diplomuarve, dhe 16% janë të papunë dhe 11% vazhdojnë studimet e mëtejshme.


Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: EB** (N=14); **HT** (N=29)

Të ndara sipas gjinisë (shih figurën 8), të dhënat tregojnë se 86% e të diplomuarve meshkuj janë të punësuar, 12% janë të papunë dhe 2% vijojnë studimet e mëtejshme. Ndërkohë, 83% e të diplomuarve të gjinisë femërore janë të punësuara, 8% janë të papuna dhe 8% janë studente ose kursante.

Figura 8: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: M** (N=42); **F** (N=12).

Lidhja e punës me fushën e arsimit

Të pyetur nëse puna aktuale lidhet me fushën e tyre të arsimit, 70% e të diplomuarve u përgjigjën pozitivisht. Ndër vitet 2016-2025 (shiko figurën 9), mesatarisht rreth 82% e të diplomuarve pohojnë se puna lidhet me fushën e tyre të studimit.

Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=6); **2017** (N=9); **2018** (N=26); **2019** (N=27); **2020** (N=41); **2021** (N=55); **2022** (N=52); **2023** (N=34), **2024** (N=35), **2025** (N=43).

Të pyetur lidhur me arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (shiko tabelën 2), vërehet se të diplomuarit e brezit 2024-2025 japin vetëm 1 arsye kryesore: Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira 13%.

Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2025)

	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Nuk gjeta një vend pune që lidhet me studimet e mia	25%	100%	83%	45%	0%	11%	50%	**0%**
Nuk dua të punoj në një punë që lidhet me studimet e mia	0%	0%	0%	18%	0%	33%	0%	**0%**
Nuk ka oferta pune në fushën time në rajon	0%	0%	17%	36%	0%	0%	17%	**0%**
Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira	75%	0%	0%	0%	100%	56%	13%	**100%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018** (N=4); **2019** (N=4); **2020 (N=6); 2021 (N=11); 2022 (N=2); 2023 (N=9), 2024 (N=6), 2025** (N=13)

Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës

Të pyetur nëse njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë studimit i përdorin në vendin e punës (shiko tabelën 3), rezultatet e gjurmimit të të diplomuarve në vitin 2025 tregojnë se njohuritë përdoren "shumë/jashtëzakonisht shumë" nga 54% e të gjurmuarve. Vihet re një rritje me 8 pikë përqindje në krahasim me vitin e mëparshëm (46%). Niveli më i lartë ka qenë ai i vitit 2019 ku 59% e të diplomuarve kanë pohuar se i përdorin njohuritë dhe kompetencat e fituara në shkollë në vendin e punës "shumë/jashtëzakonisht shumë".

Ndërkohë, asnjë prej të diplomuarve janë përgjigjur se i përdorin "aspak" njohuritë e fituara gjatë studimeve (4% mesatarja e viteve 2016-2024). Ndërsa kategoria e atyre që janë përgjigjur se i përdorin "disi" njohuritë ka pësuar një rënie me 3 pikë përqindje për vitin 2025 (33%), në raport me mesataren e viteve 2016-2024 e cila ka qenë 36%.

Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2016-2025)

	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
2016	0%	0%	50%	0%	50%
2017	0%	15%	46%	38%	0%
2018	8%	27%	42%	15%	8%
2019	0%	9%	31%	22%	38%
2020	5%	15%	24%	37%	20%
2021	5%	25%	44%	24%	2%
2022	6%	13%	35%	8%	38%
2023	4%	18%	22%	22%	33%
2024	9%	11%	29%	37%	14%
2025	**0%**	**13%**	**33%**	**24%**	**30%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=6); **2017** (N=13); **2018** (N=26); **2019** (N=32); **2020** (N=41); **2021** (N=55); **2022** (N=52); **2023** (N=45), **2024** (N=35), **2025** (N=43)

Të pyetur për lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve të kryera (shiko tabelën 4), 57% e të diplomuarve në 2025 e vlerësojnë lidhjen e pozicionit të punës me studimet e kryera me "shumë/jashtëzakonisht shumë". Këtu, vihet re një rritje me 9 pikë përqindje krahasuar me vitin 2024, ku 58% e të diplomuarve të gjurmuar e vlerësonin lidhjen mes pozicionit të punës me "shumë/jashtëzakonisht shumë". Nga ana tjetër, 17% e vlerësojnë me "pak/aspak" lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimit. Edhe në këtë kategori kemi një rënie në raport me vitin e mëparshëm me 5 pikë përqindje (23% në 2024)

Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2016-2025)


	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
2016	0%	17%	17%	33%	33%
2017	0%	15%	46%	38%	0%
2018	8%	23%	42%	15%	12%
2019	3%	19%	22%	25%	31%
2020	5%	17%	24%	27%	27%
2021	5%	25%	51%	18%	0%
2022	4%	17%	37%	15%	27%
2023	2%	18%	29%	27%	24%
2024	9%	14%	29%	34%	14%
2025	**4%**	**13%**	**26%**	**35%**	**22%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=6); **2017 (**N=13); **2018 (**N=26) **2019** (N=32); **2020** (N=41), **2021** (N=55); **2022** (N=52); **2023** (N=45), **2024** (N=35), **2025** (N=43)

Niveli i pagave

Përsa i përket nivelit të pagave për të diplomuarit e punësuar, një vit pas diplomimit, për vitin 2024 (shiko figurën 10), shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 17% deri në 50,000 lekë, 21% në fashën 50,001-60,000 lekë, 31% në fashën 60,001-80,000 lekë, 5% paguhen në fashën 80,001- 95,000 lekë, 7% paguhen në fashën 95,001- 120,000 lekë dhe 19% e të diplomuarve paguhen mbi 120,001 lekë.

Figura 10: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2025




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=43

Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara (shiko figurën 11), pasqyron një përmirësim të nivelit të pagave të të diplomuarve. Asnjë prej të diplomuarve të gjurmuar në vitin 2025 nuk merr një pagë më të vogël se 35,000 lekë,

duke shënuar një përmirësim me 20 pikë përqindje nga mesatarja 2016-2024 (20%). Gjithashtu nuk ka ndryshuar numri i atyre të cilët marrin një pagë 35,001-50,000 lekë. Për vitin 2025 vetëm 15% e të diplomuarve e merr këtë pagë, me një përmirësim prej 9 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (26%). Ndërkohë, është rritur me 4 pikë përqindje numri i të diplomuarve të cilët marrin një pagë 50,001-65,000 lekë në raport me mesataren 2016-2024 (16%) duke arritur në 20% në vitin 2025. Me 24 pikë përqindje është rritur numri i të diplomuarve të cilët marrin një pagë 65,001 – 80,000 lekë nga mesatarja (33% 2024, 9% mesatarja 2016-2024). Nga ana tjetër është rritur dhe numri i të diplomuarve të cilët marrin një pagë më të lartë se 80,001 lekë. Kështu në vitin 2025, 33% e të diplomuarve e marrin këtë pagë me një përmirësim prej 10 pikë përqindje nga mesatarja 2016-2024 (23%).


Figura 11: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=6); **2017 (**N=9); **2018 (**N=26) **2019** (N=27); **2020** (N=41), **2021** (N=55); **2022** (N=52); **2023** (N=33), **2024** (N=35), **2025** (N=43)

Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve (shiko figurën 12), vëmë re se 29% e të diplomuarve në degën Hoteleri-Turizëm paguhen më shumë se 120,001 lekë në muaj. Ndërkohë, 7% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe po 7% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes marrin një pagë 95,001 – 120,000 lekë. Një pagë 80,001-95,000 lekë e marrin 4% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 7% e të diplomuarve në Ekonomi- Biznes. Sikurse pasqyrohet edhe në figurë, 14% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 39% e të diplomuarve ne Hoteleri- Turizëm merre një pagë 60,001- 80,000 lekë. Nga ana tjetër, 14% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 36% e të diplomuarve në Ekonomi- Biznes marrin një pagë 50,001 – 65,000 lekë. Ndërsa pagë nën pagën minimale 50,000 lekë marrin 36% e të diplomuarve në Ekonomi- Biznes dhe 7% e të diplomuarve në Hoteleri -Turizëm.


Figura 12: Niveli i pagave sipas drejtimit (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%.

Nga të dhënat e disagreguara sipas gjinisë (figura 13), shohim se 22% e djemve dhe 10% e vajzave marrin një pagë më të lartë se 120,001 lekë. Ndërkohë 6% e djemve dhe 10% e vajzave marrin një pagë 95,001-120,000 lekë. Një pagë 80,001-95,000 lekë marrin 6% e djemve dhe 41% e tyre marrin një pagë 60,001-80,000 lekë. Një pagë 50,001-60,000 lekë e marrin 40% e vajzave dhe 16% e djemve. Ndërkohë, 40% e vajzave si dhe vetëm 9% (N=5) marrin pagë deri në 50,000 lekë.

Figura 13: Niveli i pagave sipas gjinisë (2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%.

Kushtet e punës

Të pyetur lidhur me karakteristikat kryesore të punës (me kohë të plotë apo të pjesshme), për të nëntë brezat e gjurmuar vërehet një punësim mbi mesataren me kohë të plotë. Përqindjen më të ulët e kanë pasur të diplomuarit e vitit 2020 me 66%. Ndërkohë, për vitin 2025, 81% e të diplomuarve shprehen se punojnë me kohë të plotë 12% me kohë të plotë sezonale dhe 7% me kohë të pjesshme. Mesatarisht, 2016-2025, 80% e të diplomuarve punojnë me kohë të plotë, 12% me kohë të pjesshme dhe 9% me kohë të plotë sezonale.


Figura 14: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt punësimit me kohë të pjesshme (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=4); **2017 (**N=7); **2018 (**N=24) **2019** (N=21); **2020** (N=32), **2021** (N=50); **2022** (N=39); **2023** (N=34), **2024** (N=31), **2025** (N=42)

Për sa i përket shpërndarjes së të diplomuarve sipas tipologjisë së kompanisë (shiko figurën 15), në brezin e fundit të të gjurmuarve vërehet se 26% e të diplomuarve punojnë në kompani me 1-4 punonjës, 36% në kompani me 5-9 punonjës dhe 31% në kompani me 10-49 punonjës. Numri i të diplomuarve që punojnë në kompani me mbi 50 punonjës është në 7%. Mesatarisht, 23% e të diplomuarve 2016-2025 punojnë në kompani me 1-4 punonjës, 42% në kompani me 5-9 punonjës, 24% në kompani me 10-49 punonjës dhe 11% në kompani me më shumë se 50 punonjës.


Figura 15: Madhësia e kompanisë (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=4); **2017 (**N=7); **2018 (**N=24) **2019** (N=21); **2020** (N=32), **2021** (N=50); **2022** (N=39); **2023** (N=34), **2024** (N=31), **2025** (N=42).

Në vitin 2025, 69% e të diplomuarve kanë një kontratë pune me punëdhënësin e tyre (shiko figurën 16). Nga ku 21% kanë një kontratë pune me afat të caktuar, 45% me afat të pacaktuar dhe 2% janë praktikantë. Ndërkohë, vihet re që është rritur në 31% numri i atyre që janë pa një kontratë me 16 pikë përqindje krahasuar me mesataren 15% të viteve 2016-2024. Sikurse vihet re edhe nga figura 16, lloji i kontratës që mbizotëron është ajo me afat të pacaktuar. Mesatarja e të dhjetë brezave të gjurmuar është 46%. Ndërkohë, mesatarja e atyre me kontratë me afat të caktuar është 36% për të dhjetë brezat e gjurmuar.


Figura 16: Lloji i kontratës (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=4); **2017 (**N=7); **2018 (**N=24) **2019** (N=21); **2020** (N=32), **2021** (N=50); **2022** (N=39); **2023** (N=34), **2024** (N=31) , **2025** (N=42)

Sipas rezultateve të gjurmimit të të dhjetë brezave, mesatarisht 80% e të diplomuarve të punësuar deklarojnë se iu paguhen kontributet e detyrueshme nga ana e punëdhënësit (shiko figurën 17). Në vitin 2025, 76% e të diplomuarve të punësuar pohojnë se ju paguhen sigurimet nga punëdhënësi, dhe 10% e tyre u shprehën që nuk iu paguhen sigurime dhe 14% nuk e dinin nëse ju paguheshin.

Figura 17: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë

është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=4); **2017 (**N=7); **2018 (**N=24) **2019** (N=21); **2020** (N=32), **2021** (N=50); **2022** (N=39); **2023** (N=34), **2024** (N=31), **2025** (N=42)

Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqësia në vendin e punës

Të pyetur se sa të sigurt dhe të stabilizuar ndjeheshin në vendin e tyre të punës, 52% e të diplomuarve në vitin 2025, u shprehën se ndjehen "të sigurt" ose "shumë të sigurt" (shiko tabelën 5). Ndërkohë, të diplomuarit që janë shprehur "shumë të pasigurt" janë vetëm 5%.

Ndërkohë, të pyetur lidhur me kënaqësinë në vendin e punës, 70% e të diplomuarve në vitin 2025 shprehen se ndjehen "të kënaqur ose shumë të kënaqur" dhe asnjë nuk është shprehur "shumë të

pakënaqur. Sikurse e tregon edhe tabela vërehet një korrelacion pozitiv mes sigurisë dhe kënaqësisë në vendin e punës.

Tabela 5: Perceptimet për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2016-2025)


	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Shumë i/e pasigurt	25%	14%	0%	5%	22%	32%	10%	3%	13%	**5%**
I/e pasigurt	0%	14%	13%	5%	16%	16%	13%	3%	3%	**9%**
Neutral	0%	29%	46%	43%	31%	24%	8%	18%	13%	**25%**
I/e sigurt	25%	43%	38%	33%	28%	20%	46%	53%	39%	**36%**
Shumë i/e sigurt	50%	0%	4%	14%	3%	8%	23%	24%	32%	**16%**
Shumë i/e pakënaqur	0%	0%	0%	5%	22%	42%	5%	3%	7%	**0%**
I/e pakënaqur	0%	14%	8%	10%	6%	12%	15%	3%	7%	**7%**
Neutral	0%	43%	50%	10%	38%	18%	13%	26%	23%	**26%**
I/e kënaqur	50%	29%	33%	48%	28%	26%	38%	41%	32%	**52%**
Shumë i/e kënaqur	50%	14%	8%	29%	6%	2%	28%	26%	32%	**18%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=4); **2017 (**N=7); **2018 (**N=24) **2019** (N=21); **2020** (N=32), **2021** (N=50); **2022** (N=39); **2023** (N=23), **2024** (N=31), **2025** (N=42)

Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për kohën që u duhet të presin derisa të fillojnë punën e tyre të parë, 86% e të diplomuarve në vitin 2025 u përgjigjën se kanë arritur të gjejnë punën para diplomimit, 10% 1 muaj pas diplomimit, dhe vetëm 5% e kanë gjetur punën brenda 6 – 9 muaj nga diplomimi.

Figura 18: Periudha kohore në kërkim të një pune (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=42

Ndërkohë, mesatarisht 66% e të diplomuarve 2016-2025 e kanë gjetur punën para diplomimit. Ndërkohë, për vitin 2025 kemi një rritje të numrit të të diplomuarve të cilët e gjejnë punën 1 muaj pas diplomimit në krahasim me vitet më përpara. Përkatësisht, 86% e të diplomuarve në vitin 2025 e kanë gjetur punën para diplomimit . Për më tepër, për vitin 2025 vërehet një ulje me 5 pikë përqindje e të diplomuarve të cilët e gjejnë punën 1 muaj pas diplomimit (10% 2025, 15% mesatarja 2016-2024). Ndërkohë, nuk kemi të diplomuar që kanë gjetur punë brenda 1 – 3 muaj dhe 3 – 6 muaj. Maksimumi i gjetjes së punës nga të diplomuarit është 6 muaj pas diplomimit.

Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2016-2025)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	**2023**	**2024**	**2025**
Para diplomimit	40%	45%	53%	77%	53%	49%	84%	67%	77%	**86%**
1 muaj pas diplomimit	40%	0%	23%	4%	11%	14%	5%	18%	10%	**10%**
1 - 3 muaj pas diplomimit	0%	36%	7%	4%	8%	8%	5%	6%	10%	**0%**
3 - 6 muaj pas diplomimit	0%	9%	7%	4%	3%	8%	2%	3%	3%	**0%**
6 - 9 muaj pas diplomimit	0%	9%	0%	4%	11%	10%	2%	3%	0%	**5%**
9 - 12 muaj pas diplomimit	0%	0%	10%	8%	14%	12%	2%	3%	0%	**0%**
Më shumë se 1 vit pas diplomimit	20%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	**0%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=5); **2017 (**N=11); **2018 (**N=30); **2019** (N=26); **2020** (N=36);**2021** (N=51); **2022** (N=43); **2023** (N=34), **2024** (N=31), **2025**(N=42)

Mënyrat e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për mënyrën e gjetjes së punës së parë, 45% e të diplomuarve të vitit 2025, e kanë gjetur punën përmes praktikës profesionale në biznes duke shënuar përqindjen më të lartë ndër vite. Gjithashtu 17% nga të diplomuarit kanë gjetur punën përmes njoftimeve për punë në faqe interneti, media sociale duke shënuar rritje me 1 pikë përqindje nga mesatarja e 2026-2024 (16%). Ndërkohë 21% e të diplomuarve kanë gjetur punë përmes njohjeve, lidhjeve familjare dhe miqve. duke shënuar një rënie prej 9 pikësh përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (30%). Për më tepër 2% e të diplomuarve në vitin 2025 e kanë gjetur punën duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësit, me një rënie prej vetëm 11 pikë përqindje nga mesatarja 2016-2024 (13%).

Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2016-2025)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	**2022**	**2023**	**2024**	**2025**
Nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë	25%	14%	8%	5%	16%	30%	18%	6%	23%	**17%**
Nga njohjet, lidhjet familjare, miqtë	75%	0%	25%	24%	31%	26%	28%	47%	19%	**21%**
Nga praktika profesionale në biznes	0%	14%	33%	38%	25%	18%	38%	32%	36%	**45%**
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim	0%	43%	29%	5%	13%	6%	3%	15%	7%	**2%**
Nga mësuesit	0%	0%	4%	14%	6%	10%	10%	0%	3%	**0%**
Nga Zyra e Punësimit	0%	14%	0%	0%	3%	2%	0%	0%	0%	**0%**
Nga qendra e karrierës/njësia e zhvillimit në shkollë	0%	14%	0%	10%	3%	8%	3%	0%	3%	**5%**
Tjetër	0%	0%	0%	5%	3%	0%	0%	0%	10%	**10%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=5); **2017 (**N=11); **2018 (**N=30); **2019** (N=26); **2020** (N=36); **2021** (N=51); **2022** (N=43); **2023** (N=34), **2024** (N=31), **2025** (N=42)

Lidhur me mënyrat e mbështetjes së shkollës në kapërcimin e fazës tranzitore drejt tregut të punës (shiko tabelën 8), në vitin 2025, 44% pohuan se shkolla i ka ndihmuar në orientimin mbi mundësitë e ndryshme për punësim (rënie me 1 pikë përqindje nga mesatarja 2016-2024, 45%), 28% pohuan se shkolla i ka mësuar se si të aplikojnë për punë (pa ndryshime në përqindje referuar mesatares 2016-2024, 28%).

Ndërkohë 26% janë shprehur se shkolla i ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë.

Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2016-2025)


	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Kam mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë	0%	31%	38%	22%	39%	35%	29%	22%	37%	**28%**
Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit	83%	23%	62%	41%	22%	40%	40%	47%	51%	**44%**
Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë	0%	8%	46%	31%	17%	29%	31%	33%	20%	**26%**
Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar	17%	38%	8%	9%	15%	4%	6%	7%	11%	**7%**
Tjetër	17%	0%	0%	3%	10%	4%	2%	0%	6%	**2%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=6); **2017 (**N=13); **2018 (**N=26); **2019** (N=32); **2020** (N=41); **2021** (N=55); **2022** (N=52); **2023** (N=45), **2024** (N=35), **2025** (N=46)

Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme

Për vitin 2025, 4% e të diplomuarve vijojnë studime të mëtejshme, duke shënuar një ulje me 6 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2016-2024 (10%). Ndërkohë, 15% janë të punësuar por edhe punojnë në të njëjtën kohë, një rritje me 5 pikë përqindje nga viti i kaluar.


Figura 19: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=8); **2017 (**N=19); **2018 (**N=45); **2019** (N=43); **2020** (N=63); **2021** (N=62); **2022** (N=61); **2023** (N=57), **2024** (N=39), **2025** (N=10)

Njëlloj si në vitin paraardhës, të gjithë të diplomuarit të cilët vijojnë studime të mëtejshme në vitin 2025, ndjekin universitetin. Mesatarisht, gjatë viteve 2016-2024, 77% e të diplomuarve që vijojnë studime të mëtejshme ndjekin universitetin, 12% shkollë profesionale pas të mesmes dhe 7% kurs profesional.


Figura 20: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=1); **2017 (**N=3); **2018 (**N=7); **2019** (N=5); **2020** (N=18); **2021** (N=7); **2022** (N=9); **2023** (N=4), **2024** (N=5), **2025** (N=2)

Ndërkohë, të gjithë të diplomuarit që vijojnë studime të mëtejshme universitare kanë përzgjedhur një institucion privat. Mesatarisht, 2020-2025 66% e të diplomuarve që ndjekin studime universitare përzgjedhin institucione publike dhe 34% ato private.


Figura 21: Lloji i institucionit (2020-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=1); **2017 (**N=3); **2018 (**N=7); **2019** (N=5); **2020** (N=18); **2021** (N=7); **2022** (N=9); **2023** (N=4), **2024** (N=4), **2025** (N=2)

Ndërkohë, të pyetur nëse studimet/trajnimet që po ndjekin lidhen me shkollën që kanë bërë (shiko figurën 22), 100% pohojnë që studimet e mëtejshme lidhen me profesionin e tyre. Viti 2024 dhe 2025 shënojnë edhe shkallën më të lartë të lidhjes se studimeve të mëtejshme me profesionin, duke shënuar edhe një rritje prej 22 pikë përqindje nga mesatarja 2020-2024 (78%).

Figura 22: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=1); **2017 (**N=3); **2018 (**N=7); **2019** (N=5); **2020** (N=18); **2021** (N=7); **2022** (N=9); **2023** (N=4), **2024** (N=5), **2025** (N=2)

Të pyetur mbi arsyet e ndjekjes së studimeve të mëtejshme (shiko tabelën 9), asnjë prej të diplomuarve në 2024 nuk është përgjigjur për të fituar një kualifikim më të lartë duke shënuar kështu përqindjen më të ulët (52% mesatarja e viteve 2016-2024), po ashtu asnjë nuk është përgjigjur për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë (27% mesatarja e viteve 2016-2025), dhe të gjithë pra 100% për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale duke shënuar rritje me 79 pikë përqindjeje (21% mesatarja e viteve 2016-2024).

Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2025)


	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Për të fituar një kualifikim më të lartë	100%	33%	71%	75%	28%	86%	22%	50%	0%	**0%**
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	0%	67%	29%	0%	33%	0%	33%	25%	60%	**0%**
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	0%	0%	0%	25%	39%	14%	44%	25%	40%	**100%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=1); **2017 (**N=3); **2018 (**N=7); **2019** (N=5); **2020** (N=18); **2021** (N=7); **2022** (N=9); **2023** (N=4), **2024** (N=5), **2025** (N=2)

Të diplomuarit pa punë

Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit për vitin 2025 është 11%. Mesatarisht, 2016-2025, 17% e të diplomuarve janë të papunë një vit pas diplomimit.


Figura 23: Papunësia ndër vite (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2016** (N=8); **2017** (N=19); **2018** (N=45); **2019** (N=43); **2020** (N=63); **2021** (N=62); **2022** (N=61); **2023** (N=57), **2024** (N=39), **2025** (N=54)

Të pyetur nëse po kërkonin punë, 67% ose në numra absolut 4 nga 6 të diplomuarit e papunë të vitit 2025 ishin në kërkim të një pune. Gjithashtuë, 33% ose 2 nga 6 nuk ishin në kërkim të një pune. Sikundër vihet re edhe nga figura 24, pjesa më e madhe e të diplomuarve të papunë ndër vite nuk kërkojnë punë. Mesatarisht, 2020-2025, 63% e të diplomuarve të papunë nuk e kërkojnë një punë.

Figura 24: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2020** (N=14); **2021** (N=7); **2022** (N=4); **2023** (N=7), **2024** (N=2), **2025** (N=6)

Nga përgjigjet e të diplomuarve të papunë që është në kërkim të një pune 50% e tyre është shprehur se është e/i angazhuar në punë familjare dhe 50% për të tjera arsye të pa listuara në pyetësor.

Tabela 10: Arsyet kryesore të papunësisë (2016-2025)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Më mungon eksperienca e punës	0%	17%	42%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	**0%**
Njohuritë që kam marrë nga shkolla nuk përputhen me tregun e punës	100%	0%	8%	9%	0%	0%	0%	0%	0%	**0%**
Ofertat për punë nuk lidhen me arsimimin tim	0%	17%	8%	27%	50%	100%	0%	0%	100%	
Nuk kam njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur një punë	0%	0%	17%	9%	50%	0%	100%	50%	0%	**0%**
Nuk ka punë në qarkun tim	0%	50%	8%	9%	0%	0%	0%	0%	0%	**0%**
Jam i/e angazhuar në punë familjare	0%	0%	17%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	**50%**
Nuk kam burime të mjaftueshme për t'u vetë-punësuar	0%	17%	42%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	**0%**
Nuk di si të kërkoj për punë	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	50%	0%	**0%**
Tjetër										**50%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2016** (N=1); **2017** (N=6); **2018** (N=12); **2019** (N=11); **2020** (N=2); **2021** (N=1); **2022** (N=2); **2023** (N=2), **2024** (N=1), **2025** (N=2),

Arsyet e moskërkimit për punë për dy të diplomuarit është aftësi e kufizuar për tu integruar në tregun e punës.


Tabela 11: Arsyet kryesore të mos kërkimit për punë (2020-2025)

	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Po pres të filloj punë së shpejti	0	0	2	1	1	0
Nuk kam besim se do gjej një punë	3	1	0	1	0	0
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	3	2	0	1	0	0
Kam në plan të largohem nga vendi	2	1	0	2	0	0
Tjetër	3	0	0	0	-	2

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2020** (N=12); **2021** (N=6); **2022** (N=2); **2023** (N=5), **2024** (N=1), **2025** (N=2)

Sikurse e tregon edhe figura 25, numri i të diplomuarve të papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune më parë për vitin 2025 është 33% (N=2 out of 6).

Figura 25: Niveli i të diplomuarve të papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2016** (N=1); **2017** (N=6); **2018** (N=12); **2019** (N=11); **2020** (N=14); **2021** (N=7); **2022** (N=4); **2023** (N=7), **2024** (N=2), **2025** (N=6)

Propozimet për përmirësim në shkollë

Të pyetur se për çfarë aspektesh ka nevojë për përmirësim shkolla me qëllim përgatitjen më të mirë të nxënësve për tregun e punës, të gjurmuarit pohuan se të gjitha aspektet e shkollës të paraqitura në tabelën

12 kanë "shumë/jashtëzakonisht shumë" nevojë për përmirësim. Sipas rezultateve të të diplomuarve në vitin 2025, mbi 50% e të gjurmuarve vlerësojnë se çdo aspekt i shkollës ka nevojë për përmirësim "shumë/jashtëzakonisht shumë". Theksi këtë vit është tek nevoja për përmirësim t; praktikës në shkollë me 62% (me një rritje me 7 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve 2018-2024, 55%). Për më tepër, kërkohet të përmirësohen tekstet dhe materialet (57%), praktika në biznes (57%), bashkëpunimi me bizneset (56%), kurrikula (55%) dhe bashkëpunimi me zyrat e punësimit (55%).


Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkollë "shumë/jashtëzakonisht shumë" (2016-2025)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Infrastruktura	17%	62%	4%	38%	52%	18%	26%	50%	54%	**53%**
Kurrikula			8%	53%	46%	22%	26%	55%	56%	**55%**
Tekstet dhe materialet	67%	46%	12%	47%	41%	17%	30%	56%	49%	**57%**
Metodat e mësimdhënies	33%	39%	8%	47%	30%	20%	31%	54%	58%	**53%**
Aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve			15%	50%	30%	22%	30%	53%	64%	**55%**
Praktika në shkollë	33%	31%	12%	63%	44%	14%	36%	61%	53%	**62%**
Praktika në biznes	33%	23%	12%	59%	44%	20%	41%	63%	51%	**57%**
Këshillimi i karrierës	33%	0%	12%	50%	44%	20%	36%	61%	56%	**54%**
Bashkëpunimi me bizneset	33%		12%	53%	41%	15%	39%	61%	54%	**56%**
Bashkëpunimi me zyrat e punësimit	0%	8%	8%	56%	33%	12%	28%	60%	50%	**55%**

Shënim: Kjo është pyetje ku janë marrë të dhënat e të diplomuarve që janë përgjigjur "shumë/jashtëzakonisht shumë". Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza**: **2016** (N=6); **2017** (N=13); **2018** (N=26); **2019** (N=32); **2020** (N=63); **2021** (N=60); **2022** (N=61); **2023** (N=57), **2024** (N=36), **2025** (N=53)

Nëse do të kishin mundësi, 87% e të diplomuarve do të përzgjidhnin shkollë dhe 89% do të përzgjidhnin të njëjtën degë. Mesatarisht, gjatë viteve 2016-2025, 79% e të diplomuarve do të përzgjidhnin të njëjtën degë dhe 80% do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë.

Figura 26: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018** (N=45); **2019** (N=43); **2020** (N=63); **2021** (N=62); **2022** (N=61); **2023** (N=57), **2024** (N=39), **2025** (N=54)

Të disagreguara sipas drejtimeve, përzgjedhja e të njëjtës degë dhe shkollë paraqitet në tabelën 13. Vëmë re se 90% e të diplomuarve të degës Ekonomi-Biznes do e përzgjidhnin të njëjtën degë, me një rritje prej 44 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024, 66%,. Ndërkohë, këta të diplomuar do përzgjidhnin të njëjtën shkollë në masën 84%, me një rritje prej 12 pikësh përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024 (72%).

Ndërkohë të diplomuarit në degën Hoteleri-Turizëm do të përzgjidhnin të njëjtën degë në masën 89% me një rritje prej 7 pikësh përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024 (82%), dhe 89% do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë me një rritje po prej 7 pikësh përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024 (82%).

Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2016-2025)


		Ekonomi-Biznes	Hoteleri-Turizëm
2018	Degë	25%	91%
	Shkollë	75%	94%
2019	Degë	94%	85%
	Shkollë	100%	85%
2020	Degë	37%	72%
	Shkollë	41%	69%
2021	Degë	84%	72%
	Shkollë	42%	84%
2022	Degë	89%	85%
	Shkollë	89%	88%

2023	Degë	64%	74%
	Shkollë	64%	65%
2024	Degë	70%	97%
	Shkollë	90%	90%
2025	Degë	**90%**	**89%**
	Shkollë	**84%**	**89%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2018**: N_{EB}=12, N_{HT}=33; **2019**: N_{EB}=16, N_{HT}=27; **2020**: N_{EB}=27, N_{HT}=36; **2021**: N_{EB} =19, N_{HT} =43; **2022:** N_{EB}=9, N_{HT}=52; **2023:** N_{EB}=14, N_{HT}=41, **2024:** N_{EB}=10, N_{HT}=29, **2025:** N_{EB}=19, N_{HT}=35

Ndërkohë të disagreguara sipas gjinisë të dhënat jepen në figurën 27. Sikurse vërehet, 88% e djemve dhe 83% e vajzave do të përzgjidhnin të njëjtën degë Gjithashtu, 88% e djemve dhe 92% e vajzave do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë.

Figura 27: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi dhe e së njëjtës shkollë sipas gjinisë 2025



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N_M=42; N_F=12

Planet për të ardhmen

Të pyetur për planet që kanë të diplomuarit për të ardhmen e tyre të afërt në aspektin profesional dhe të kualifikimit të mëtejshëm (shiko tabelën 14), pothuajse gjysma e të diplomuarve në vitin 2025 (46%) kanë pohuar se kanë dëshirë të kenë filluar biznesin e tyre. Aspiratat për sipërmarrje edhe këtë vit kanë shënuar një rritje me 10 pikë përqindje në raport me mesataren e viteve 2016-2024, 36%.

Ndërkohë, 22% e të diplomuarve kanë dëshirë të ndjekin studime të mëtejshme, gjithsesi me një ulje prej 5 pikësh përqindje në raport me mesataren e viteve 2016-2024, 27%. Për më tepër 24% duan të kenë gjetur një punë që lidhet me fushën e tyre të studimit, me një rritje me 1 pikë përqindje sa mesatarja e viteve 2016-2024, 23% dhe 19% duan të jenë të punësuar. Këta të fundit kanë pësuar një rënie me 5 pikë përqindje në raport me mesataren e viteve 2016-2024, 14%.

Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2016-2025)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Të jem punësuar	0%	5%	20%	16%	10%	16%	25%	21%	10%	**19%**
Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit	13%	0%	33%	30%	27%	29%	23%	28%	23%	**24%**
Të kem filluar biznesin tim	13%	5%	51%	28%	27%	52%	41%	54%	51%	**46%**
Të kem ndjekur studime të mëtejshme	13%	42%	44%	30%	14%	45%	15%	18%	26%	**22%**
Të kem emigruar jashtë vendit	13%	37%	51%	28%	44%	66%	15%	30%	5%	**13%**
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	13%	5%	7%	5%	3%	10%	2%	2%	5%	**0%**
Tjetër	75%	5%	0%	2%	3%	0%	2%	0%	3%	**7%**

Shënim: Kjo është pyetje me përgjigje të shumëfishta. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza**: **2016** (N=2); **2017** (N=19); **2018** (N=45); **2019** (N=43); **2020** (N=63); **2021** (N=62); **2022** (N=61); **2023** (N=57), **2024** (N=39), **2025** (N=54)

Rekomandime për forcimin institucional

Rekomandimet e mëposhtme lidhen drejtpërdrejt me gjetjet e raportit të gjurmimit për Shkollën Tregtare Vlorë. Për brezin 2025 janë gjurmuar të gjithë 54 të diplomuarit. Për nëngrupet me pak përgjigje, hapi i parë është sqarimi i situatës përmes kontakteve individuale. Mospërputhjet në raport duhen verifikuar para përdorimit të treguesve në planifikim.

1. Praktikë më cilësore në shkollë dhe biznes

Planet e praktikës të rishikohen me mësuesit, mentorët dhe të diplomuarit, duke identifikuar detyrat dhe aftësitë që kërkojnë më shumë ushtrim. Të ruhen partneritetet që mundësojnë kalimin nga praktika në punësim dhe të ndiqet cilësia e përvojës së nxënësve.

Gjetja: Përmirësimin e praktikës në shkollë e kërkojnë 62% e të diplomuarve që iu përgjigjën pyetjes, ndërsa praktikën në biznes 57% (N=53). Ndërkohë, 45% e kanë gjetur punën e parë përmes praktikës në biznes (N=42), duke e bërë atë një kanal të rëndësishëm punësimi.

2. Materiale dhe përmbajtje mësimore më të dobishme për punën

Ekipet lëndore të përdorin mendimet e të diplomuarve dhe bizneseve për të rishikuar materialet, shembujt dhe detyrat praktike. Të identifikohen njohuritë që përdoren më pak dhe mënyrat për t'i lidhur me situata konkrete pune.

Gjetja: Përmirësimin e teksteve dhe materialeve e kërkojnë 57% dhe të kurrikulës 55% (N=53). Vetëm 54% raportojnë se i përdorin njohuritë e fituara në shkollë "shumë" ose "jashtëzakonisht shumë" në punë (N=43).

3. Më shumë vëmendje ndaj kontratave dhe sigurimeve

Orientimi në karrierë të përfshijë informacion praktik për kontratat, kushtet e punës dhe verifikimin e sigurimeve. Në kontaktet pas diplomimit të identifikohen të diplomuarit që kanë nevojë për sqarim ose orientim drejt shërbimeve përkatëse.

Gjetja: Në 2025, 31% e të punësuarve me përgjigje të vlefshme raportojnë se nuk kanë kontratë. Gjithashtu, 10% deklarojnë se nuk u paguhen sigurimet dhe 14% nuk e dinë nëse u paguhen (N=42).

4. Mbështetje për kërkimin e punës dhe pengesat individuale

Shkolla të ofrojë ushtrime praktike për përgatitjen e CV-së, aplikimin dhe intervistën, si dhe referime te punëdhënësit dhe zyra e punësimit. Të diplomuarit pa punë të kontaktohen individualisht për të kuptuar pengesat dhe mbështetjen që u nevojitet.

Gjetja: Vetëm 28% raportojnë se shkolla i ka mësuar të kërkojnë dhe të aplikojnë për punë, ndërsa 26% se i ka ndihmuar të vendosin kontakte me punëdhënës (N=46). Nga 6 të diplomuarit pa punë, 4 kërkojnë punë. Për 2 të tjerët, raporti përmend aftësinë e kufizuar si pengesë për integrimin në tregun e punës, çka kërkon mbështetje të përshtatur.

5. Mbështetje praktike për interesin për sipërmarrje

Të diplomuarve që synojnë hapjen e një biznesi t'u ofrohet këshillim për zhvillimin e idesë, vlerësimin e tregut dhe planifikimin financiar. Të krijohen kontakte me sipërmarrës dhe shërbime mbështetëse sipas profilit.

Gjetja: Në 2025, 46% dëshirojnë të kenë filluar biznesin e tyre brenda dy viteve, ndërsa rreth 7% janë aktualisht të vetëpunësuar (N=54). Ky dallim sugjeron nevojën për të kuptuar sa të konkretizuara janë planet dhe çfarë mbështetjeje kërkohet.